



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS

Kryetari i Komunës

10. 03. 2017

01.nr. 512/03-0052127 më _____

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, dt. 25.02.2010, Vendimit me nr. 01-400-93043 dt. 30.04.2015, Kryetari i Komunës së Prishtinës, miratoi këtë

V E N D I M

- I. Miratohet vendimi për mbulimin e shpenzimeve të funeralit për dy fëmijët e vdekur tragjikisht në lagjen "Kolovicë"-Prishtinë.
- II. Shuma e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve të funeralit bëhet sipas vendimit me nr. 01-400-93043 dt. 30.04.2015, për mbulimin e shpenzimeve të funeralit.
- III. Shuma e mjeteve sipas pikës II të këtij vendimi, do të bëhet në xhironlogarinë përkatëse në Pro Credit Bank me nr. 1160023488000114, në emër të Artan Ufla, i cili ka kryer shpenzimet e funeralit sipas Dëftesës së lëshuar nga Bashkësia Islame e Kosovës 0096315 dt.15.02.2016.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

I dërgohet:

- Drejtorisë së Financave,
- Qendrës për shërbime me qytetarë,
- Në dosje.

Kryetari i Komunës

Shpend Ahmeti



10. 03. 2017

838/1091